**Statuti**
**I shoqerise me pergjegjesi te kufizuar**
**"GrifAL " sh.p.k**
**Forma e Shoqerise**

**Neni 1**

Sot, me 22.11.2023 ne themeluesit, Gjergji Çërra, Eliza Naço, Fabiola Hoxha, Anduela Hoxha dhe Admir Skanja, kemi krijuar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emrin **"GrifAL" sh.p.k.** Veprimtaria e saj rregullohet nga ky Statut e Akti i Themelimit i cili eshte i njejte me statutin dhe legjislacionin shqiptar ne fuqi.
Akti i Themelimit dhe Statuti jane ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe cdo ceshtje e paparashikuar shprehimisht ne to, rregullohet sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.
Themelues te shoqerise jane:
1. Gjergji Çërra, shtetas shqiptar, i datelindjes 26.05.1983 lindur ne Berat dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes i pasaportes me nr. BF4618012 dhe nr. personal I30526057R.
2. Eliza Naço, shtetase shqiptare, e datelindjes 14.12.1995 lindur dhe banuese ne Tirane, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e kartes ID 037883215 dhe nr. personal J56214052P .
3. Fabiola Hoxha, shtetase shqiptare, e datelindjes 05.02.1990, lindur dhe banuese ne Lushnje, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e pasaportes me nr. BR1858613 dhe nr. personal J05205125S .
4. Anduela Hoxha, shtetase shqiptare, e datelindjes 06.10.1983 lindur dhe banuese ne Tirane, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e kartes ID 038061765 dhe nr. personal I36006080R .
5. Admir Skanja shtetas shqiptar, i datelindjes 18.03.1984 lindur ne Shkoder dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes kartes se identitetit me nr 037190417 dhe nr. personal I40318065J.

**Qendra e Shoqerise**
**Neni 2**

Selia e Shoqërisë **"GrifAL" sh.p.k.** ndodhet ne adresën: Njesia Bashkiake nr 2, rruga "Xhorxh W Bush", godina nr 17, kati i dyte, Tirane.
Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithe vendin.

**Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike**
**Neni 3**

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte e pakufizuar.

**Objekti I veprimtarise se shoqerise**
**Neni 4**

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

Ne fushen e ndertimit shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe / ose jopublike te veprave me karakter shfrytezimi dhe / ose administrimi publik dh/ose privat si: ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, digave dhe veprave bonifikuese e ujore, ujesjellesave, linjave mbitokesore dhe nentokesore per energjine dhe telekomunikacionet, ndertimin dhe reabilitimin e veprave ujitese, centralet, objektet turistike, objektet ushtarake, objektet e kutlit, rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet, objektet industriale, te gjitha restaurimet ne pergjithesi, rikonstruksione te veprave te artit, montimet e konstruksioneve metalike: si dhe çdo ndertim tjeter i cili ne perfundim perben send te paluajtshem sipas nenit 142 te Kodit Civil per shkak te trupezimit ne menyre te qendrueshme e te vazhdueshme me token ose ndertesen ku eshte vendosur. Ne fushen e tregtise shoqeria do te kryeje: Tregtimin dhe import - eksportin e mallrave te ndryshem si, Industriale e artikujve te ndryshem ne pergjithesi e vecanrisht elemente te ndryshem e paisje elektrike, mekanike, elektronike, materiale te ndryshme ndertimi dhe aksesoret perkates. Montimi e prodhimi i elementeve te paisjeve te ndryshme elektronike, elektroteknike, elektronike elektromekanike perfshire kondicioner, elektroshtepiake etj te ketij lloji. Bojrave te ndryshme me baze ujore dhe baze vajore per lyerje te fasadave te murit, te drurit te hekurit etj, stuko patinimi koll, poliretaneve dhe te veglave te punes qe perdoren per lyerjen e tyre, materialeve te tjera te ndertimit, duhan cigareve te te gjitha llojeve, industriale, ushqimore , mjekesore, te ndertimit, te, mediave, te mjeteve kryesore dhe ndihmese te prodhimit, te makinerive, te metaleve ferroze dhe jo ferroze, te lendes drusore, te lendeve te para dhe te perpunuara per procesin e prodhimit, tregtimin e pasurive te luajtshme e te paluajtshme, shitblerjen e tokes, tregtimin e mallrave te gatshem e gjysem te gatshme etj. Ne fushen e turizmit shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe / ose jopublike te infrastruktures dhe / ose te pjeseve perberese te saj, per shfrytezimin njerezor me karakter pushues, argetues, edukues dhe / ose kurues, te burimeve natyrore, kulturore, mjedisore kurative, te Shqiperise dhe me gjere. Ne fushen e transportit, shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe / ose jopublike te infrastruktures dhe / ose te pjeseve perberese te saj, per transportimin publik dhe / ose privat te njerezve dhe mallrave brenda dhe jashte territorit te vendit si dhe tranzitimin e tyre pergjate territorit te Shqiperise nepermjet transportit rrugor, hekurudhor, ajror, ujor, teleferik etj Ne fushen e mjedisit shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe / ose jopublike te mbrojtjes dhe ose permiresimit si dhe rehabilitimit te kushteve te mjedisit rrethues; perpunimin e mbetjeve urbane, toksike, radioaktive, teknologjike si dhe mbetje te çdo lloji tjeter, trajtimi i ujrave industriale, projektimin, mbikqyrjen ne fushen e kerkimit dhe shfrytezimit te lendes drusore, trajtimin dhe mbrojtjen e pyjeve, riaftesimin dhe trajtimin e tokave te kripura e kenetave si dhe çdo veprimtari qe ka rendesi per shoqerine. Ne fushen e prodhimit shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe / ose jopublike te materialeve te ndertimit, te lendeve te para per ndertim, shfrytezimin e minierave per lende te pare per ndertim, prodhimin e inerteve, te asfalto - betonit,betonit, prodhimin e vajrave te ndryshme

ushqimore dhe jo ushqimore, prodhimin e sapuneve, prodhimet e konstruksioneve metalike, beton armeje, plastike, te drurit dhe kombinime te ndryshme te tyre, prodhimin e motorrave dhe transformatoreve elektrike, transformatoret e tensionit te larte, furrave elektrike te çdo tipi dhe te gjitha paisjeve elektrike, studime dhe projektime per paisje dhe makineri elektrike. Tregetimin e prodhimin e sistemeve dhe paisjeve kunderzjarrit ne te gjithe gamen e tyre. Ne fushen e sherbimeve shoqeria do te kryeje: Dhenien me qera te aseteve te shoqerise ( te godinave dhe te truallit ) prodhim dhe tregtim mobilje alumin pvc ( plastike dhe druri ) tregti bojra te ndryshme vegla pune te te gjitha llojeve paisje hidraulike dhe elektro shtepiake, elektrike, materiale ndertimi te te gjitha llojeve, prodhim ndertim fasadash, bar dhe restorante. Konsulence teknike ne fusha te ndryshme.Grumbullim, perpunim, konservim dhe tregtim fruta perime me shumice dhe pakice,bujqesi dhe blektori si dhe ambjentet ndihmese te tyre,prodhimin e produkteve dhe kultivimin e tyre. Transportim i mbetjeve te dheut dhe mbetjeve inerte nga ndertimet/prishjet (jo te rrezikshme). Prodhues i pllakave te trotuarit, bordura betoni,tuba betoni dhe puseta betoni. Shoqeria mund te zhvilloje cdo lloj aktiviteti tjeter te lejuar nga legjislacioni shqiptar.

**Neni 5**

Kjo shoqeri mund te ndryshoje emertimin e saj, vendqendrimin, objektin e aktivitetit, te shtoje ortake, te rrise kapitalin sipas vendimeve te asamblese se ortakeve.

**Kapitali I shoqerise**

**Neni 6**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 (Njeqind mije) Leke .

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme qe nenkuptohet i perbere nga 5(pese) kuota me vlere te pergjithshme prej 100 000 leke. Keto kuota i perkasin ortakeve si me poshte:

1. Gjergji Çërra, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 20 000 leke, qe perben 20% te kapitalit themeltar te shoqerise.
2. Eliza Naço, zoteruese e 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 20 000 leke, qe perben 20% te kapitalit themeltar te shoqerise.
3. Fabiola Hoxha, zoteruese e 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 20 000 leke, qe perben 20% te kapitalit themeltar te shoqerise.
4. Anduela Hoxha, zoteruese e 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 20 000 leke, qe perben 20% te kapitalit themeltar te shoqerise.
5. Admir Skanja, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 20 000 leke, qe perben 20% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Ky kapital mund te shtohet sipas dispozitave ligjore dhe sipas vendimit te ortakeve.

**Drejtimi dhe administrimi**

**Neni 7**

Shoqeria tregtare deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave qe permban ky Statut si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

**Neni 8**

Ortaket e shoqerise me krijimin e kesaj shoqerie, pjesen e kapitalit te derdhur prej tyre nuk mund ta terheqin. Kjo mund te behet vetem pasi te nxirret bilanci i shoqerise per fitimin e realizuar.

**Neni 9**

Emertimi i shoqerise tregtare, kapitali themeltar, emrat e administratoreve si dhe emrat e ortakeve duhet te jene te permendura ne te gjitha aktet e nxjerra nga kjo shoqeri dhe qe ju drejtohen te treteve. Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme dhe me permbajtjen perreth saj.

**Neni 10**

Shoqeria vepron nen regjimin e prones private dhe merr persiper vete te drejtat dhe detyrimet kontraktore dhe jashte kontraktore. Ortaket e shoqerise drejtojne procesin per zhvillimin e aktivitetit te shoqerise si dhe per detyrimet qe ka shoqeria ndaj te treteve pa asnje kufizim.

**Kompetencat e ortakeve**

**Neni 11**

Per menyren e drejtimit dhe ushtrimit te aktivitetit te shoqerise, ortaket shprehen me vendime per gjithcka qe eshte ne kompetencat e tyre te pershkruara si me poshte:

Kane te drejte te bejne ndryshime ne statut.

Kane te drejte te miratojne bilancin e shoqerise dhe te bejne ndarjen e fitimit.

Ata emerojne administratoret,zevendesit,ekspertet dhe revizoret kontabel.

Ata aprovojne cdo lloj veprimi financiar qe me ligj dhe me marreveshje lihet ne kompetencat e tyre

Miratojne zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit

Percaktojne shperblimin per administratorin, ekspertet, revizoret kontabel.

Bejne transferimin e kuotave tek te tretet.

Bejne lidhjen e kontratave per dhenie dhe marrje te drejtash ose ekskluzivitet per tregtimin dhe prodhimin e mallrave te shoqerise si dhe kontrata ne lidhje me organet shteterore per pjesmarrjen ne tender, ankande ose aktivitete te tjera te rendesishme

Realizojne blerje,shitje si dhe tjetersim te pasurive te paluajtshme te shoqerise.

Kane te drejte te bejne modifikimin e kontrates se shoqerise,etj.

**Neni 12**

Kompetencat e ortakeve, mbajtja e procesverbaleve dhe te gjitha dokumentat e tjera qe kane te bejne me te duhet te behen sipas legjislacionit ne fuqi per kete qellim.

**Administrimi**

**Neni 13**

Administrator i shoqerise eshte Fabiola Hoxha, e bija e Haxhi e Merushe, shtetase shqiptare, e datelindjes 05.02.1990, lindur e banues ne Lushnje, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtese e pasaportes me nr. BR1858613 dhe nr. personal J05205125S .

Afati i mandatit eshte 5 (pese) vjet.

**Neni 14**

Administratori mund te emeroje nje ose me shume administrator te deleguar ose perfaqesues te thjeshte per te kryer veprime te vecanta duke percaktuar fuqine e tyre brenda kufijve e duke respektuar statutin dhe ligjet ne fuqi. Detyrat e tyre do te percaktohen ne nje regullore te brendshme te shoqerise.

**Neni 15**

Administratori ka liri te plote per drejtimin e zakonshem te shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha llojet e veprimeve dhe cdo lloj marreveshje per realizimin e qellimeve te shoqerise duke perjashtuar rastet qe jane te parashikuara ne ligj dhe Statut qe I takojne ortakeve. Raporti I administrimit, inventari dhe llogarite vjetore hartohen nga Administratori.

**Marredheniet e punes**

**Neni 16**

Marredheniet e punes rregullohen nepermjet kontrates se punes dhe legjislacionit te punes ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punesimit dhe te punesuarit jane te detyruar qe te respektojne Statutin e kesaj shoqerie dhe rregullat e brendeshme te saj. Te punesuarit duhet te pergjigjen per demet qe I shkaktojne kesaj shoqerie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

**Konfidencialiteti, ruajtja e sekretit**

**Neni 17**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet e te gjitha akteve dhe dokumentave qe jane percaktuar si te tilla nga administratori I shoqerise.

**Ekspertet ose revizoret kontabel**

**Neni 18**

Kontrolli mbi veprimtarine e shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e shoqerise I besohet nje eksperti ose revizori kontabel. Ky ekspert do te qendroje ne detyre per aq sa percaktohet me ligj dhe mund te rizgjidhet. Ortaket caktojne dhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

**Viti financiar, bilanci vjetor, shperndarja e fitimeve**

**Neni 19**

**Viti financiar**

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 dhjetor te secilit vit. Viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te shoqerise ne QKR dhe perfundon me 31 dhjetor te te njejtit vit.
Miratimi I dokumenteve qe lidhen me vitin financiar duhet te behen brenda 6 muajve qe nga fundi I vitit financiar.

**Bilanci dhe fitimet**

**Neni 20**

Veprimtaria ekonomike do te mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti. Administratori merr masa per hartimin e bilancit ,rezultatit ekonomik fitim-humbje dhe inventarit. Pasi vecohen fondet si me siper paguhen detyrimet fiskale, te ardhurat qe mbeten I kalojne ortakeve te shoqerise.

**Neni 21**

Ne rast se kapitali I shoqerise per shkak te humbjeve te realizuara rezulton me pak se kapitali themeltar, ortaket vendosin brenda 4 muajve mundesine e prishjes se jashtezakonshme te shoqerise.

**Shperndarja dhe likuidimi I shoqerise**

**Neni 22**

Ne rast se shoqeria shperndahet per cdo lloj arsye asambleja e ortakeve percakton menyren e likuidimit, emeron nje ose me teper likuidator dhe pergatit te gjitha dokumentat e nevojshme per cregjistrimin e saj nga regjistri tregtar.

**Librat e shoqerise**

**Neni 23**

Po keshtu shoqeria ne baze te ligjit mban librat e meposhtem:

1-libri i ortakeve

2-libri i mbledhjeve

3-libri i vendimeve te administratorit

4-libri i mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve ose revizoreve kontabel

Librat e mesiperm duhet te jene te ruajtura per 10 vjet e cdo faqe duhet te jete e vulosur.

**Dispozita te pergjithshme**

**Neni 24**

Per sa eshte shprehur ne kete statut i referohemi Ligjit 9901,date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar , Ligjit 9723,date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”, i ndryshuar, Statutit dhe regullores se brendshme te shoqerise. Cdo ndryshim behet ne te njejten menyre sic eshte nxjerre ky statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kesaj shoqerie.

**Ortaket e**

**Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar**

**“GrifAL” sh.p.k.**

**Gjergji Çërra** — GJERGJI ÇERRA

**Eliza Naço** — Eliza Naco

**Fabiola Hoxha** — Fabiola Hoxha

**Anduela Hoxha** — Anduela Hoxha

**Admir Skanja** — ADMIR SKANJA

**Tiranë më 22.11.2023**